



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3280/ 6 prot.

Datë 20.11.2024

V E N D I M
Nr. 1650/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.11.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BAULED” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e larte monetar, marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik me kushtet të përcaktuara”, me Nr. REF-20508-09-18-2024 me objekt “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake, infrastrukturore, nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale elektrike, Loti 2 (Faza III).”, me fond limit 250,000,000 Lek pa TVSH. Sipas kursit të kembimit valutor të banikes së Shqipërisë vlera është 2,519,145.50 Euro. Financimi i këtij objekti është parashikuar në programet buxhetore për periudhën 2024-2026. Programi IVR, me kod projekti 24AE903, zhvilluar në datën 21.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK, me NUIS K11323001H, me adresë: Rruga Dytesore Autostrada Tirane-Dures, Km 5, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë.
Subjekte të Interesuar:	Operatori ekonomik “BAULED” SHPK, me NUIS L64506201V, me adresë: Fushë Kruje Durrës Fushë Krujë, Lagjja Hasan, numri i pasurisë 6/27, zona kadastrale nr.1934.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik ankimes ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.09.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e larte monetar, marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik me kushtet të përcaktuara”, me Nr. REF- 20508-09-18-2024me objekt “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake, infrastrukturore, nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale elektrike, Loti 2 (Faza III).”, me fond limit 250,000,000 Lek pa TVSH. Sipas kursit të kembimit valutor të bankës së Shqipërisë vlera është 2,519,145.50 Euro. Financimi i këtij objekti është parashikuar në programet buxhetore për periudhën 2024-2026. Programi IVR, me kod projekti 24AE903, zhvilluar në datën 21.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 21.10.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 28.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “BAULED“ sh.p.k NUIS L64506201V, vlera 123,999,883 lekë pa tvsh I Kualifikuar
2. OE “ITE GROUP” sh.p.k NUIS K11323001H, vlera 139,281,980 lekë pa tvsh I Kualifikuar
3. BOE "PREKA" sh.p.k NUIS K46420001I & "NDERTUESI 2014" sh.p.k NUIS L46827004LI, vlera 144,130,700 lekë pa tvsh I Kualifikuar
4. OE “START CO” sh.p.k NUIS L11614001S, vlera 147,353,110 lekë pa tvsh I Kualifikuar
5. OE: “HTM” sh.p.k NUIS K97006004D, vlera 149,912,945 lekë pa tvsh i Kualifikuar
6. BOE “ELAL COM” sh.p.k NUIS K72418010P & “ALBAELETTRICA” sh.p.k NUIS J61826012K, vlera 172,163,973 lekë pa tvsh I Kualifikuar
7. OE "CURRI" sh.p.k. NUIS J67902718S, vlera 194,769,560 lekë pa tvsh I Kualifikuar
8. OE “VIBTIS” sh.p.k NUIS L02103503S, vlera 195,085,099.29 lekë pa tvsh I Kualifikuar
9. OE “ELECTRICAL POËER ENGINEERING ” sh.p.k NUIS K81511012V, vlera 123,429,088 lekë pa tvsh I Skualifikuar

II.4. Në datën 30.10.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 75, datë 04.11.2024, sipas së cili është publikuar fitues operatori ekonomik “BAULED” SHPK.

II.5. Në datën 08.11.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3280/2024 protokoli, me datë 06.11.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4760 e operatorit ekonomik “ITE GROUP” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BAULED” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3280/2 prot., datë 11.11.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “ITE GROUP” SHPK, që pretendon për mospërbushje të kriterëve të kualifikimit, me anë të ankesës me nr. 3280/2024 prot., datë 08.11.2024.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 4295 prot., datë 14.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3280/3 prot., datë 18.11.2024, me objekt “Vendim” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues (Vendimi datë 14.11.2024 KSHA), ku konstatohet, se e ka **e ka refuzuar** atë.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ITE GROUP” SHPK, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “BAULED” SHPK “Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik BAULED SHPK, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton ofertë anomalisht e ulët dhe për ta justifikuar atë Operatori Ekonomik BAULED SHPK duhet të plotësojë, në mënyrë kumulative kushtet e parashikuara në shkronjat a), b), c) dhe ç) të pikës 2 të nenit 93 të LPP. Barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Operatori Ekonomik BAULED shpk, nuk e ka justifikuar ofertën anomalisht të ulët në bazë të ligjit shkronjat a), b), c), ç) të pikës 2 të Nenit 93 pika 2 e LPP”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së, me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 3280/3 prot., datë 18.11.2024, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e operatorit ekonomik “BAULED” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO me datë 23.10.2024 nëpërmjet SPE, i është drejtuar operatorit ekonomik “BAULED” SHPK me kërkesë që brenda 3 ditëve pune të paraqesë pranë autoritetit shpjegime, në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, të cilat duhet t’i argumentonte dhe dokumentonte edhe me prova shkresore.

III.1.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë KPP-së me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 3280/3 prot., datë 18.11.2024, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor më datë 25.10.2024 operatori ekonomik “BAULED” SHPK ka ngarkuar në SPE argumentimin me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

- *Analiza e çmimeve të ofertuara;*
- *Oferta e tubove elektrik nga furnizuesi;*
- *Kontratë furnizimi me datë 07.10.2024 për mallrat tela kabulla, elektroda tokëzimi dhe aksesore;*
- *Deklaratë doganore R36778 me datë 18.10.2023 për krahë shtylle për ndricues rruge;*
- *Deklaratë doganore R36778 me datë 18.10.2023 për aksesore për ndricues rruge;*
- *Deklaratë doganore R11076 me datë 23.03.2024 për ndricues rruge;*
- *Deklaratë doganore R11076 me datë 23.03.2024 për cip LED;*
- *Deklaratë doganore R36771 me datë 18.10.2023 ndricues rruge;*
- *Deklaratë doganore R36771 me datë 18.10.2023 krah shtylle për ndricues rruge;*
- *Deklaratë doganore R42239 me datë 22.11.2023 shtylle për ndricues rruge;*
- *Deklaratë doganore R42239 me datë 22.11.2023 krah për shtylle për ndricues rruge;*
- *Ofertë për ndricuesit;*
- *Argumentim i ofrës ekonomike;*

III.1.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:
“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.1.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “BAULED” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 123,999,883 lekë pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 93, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku

katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, KPP gjykon, se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Pra, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore.

Referuar nenit 93, pika 3, të LPP-së, autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. KPP gjykon, se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve/furnizimit të mallit në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit/punës/furnizimit me mall gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët.

Gjithashtu, KPP thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.7. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “BAULED” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “BAULED” SHPK është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik lidhur me argumentimin/sqarimin e ofertës anomalisht të ulët.

Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “BAULED” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë analitike përmes shkresës me datë 25.10.2024 me lëndë “*Kthim përgjigje kërkesës për justifikimin e Ofertës Anomalisht të Ulët*”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë si dhe me dokumentacion provues.

Përveç kësaj, KPP vëren, se operatori ekonomik “BAULED” SHPK në mbështetje të deklarime më sipër, me qëllim argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka përcaktuar përmes një tablele një analizë për artikullin objekt-prokurimi, duke detajuar analizën e kostos në trajtë analitike e konkretisht duke përcaktuar: *Tabelë analitike për analizën për ofertën anomalisht të ulët (emërtimi i mallit, njësia, sasia, çmimi i ofertuar/njësi, cmimi i blerjes brenda vendit, shpenzime plotësuese 8 %, marzhi i fitimit mbi kosto, fitimit sipas artikujve)*. Gjithashtu, ankimuesi ka paraqitur, ofertat nga furnizuesit, kontrata furnizimi nga furnizuesit, argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon të shoqëruara me dokumente provuese dhe Deklarata Doganore siç janë përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi.

Siç u përmend më lart, përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon të shoqëruara me dokumente provuese, operatori ekonomik “BAULED” SHPK ka paraqitur edhe analizën e detajuar të kostos në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP-së, ku flitet për anën ekonomike të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjitha elementet, duke

përfshirë edhe koston e magazinimit, administrative dhe koston e transportit. Pra, operatori ekonomik “BAULED” SHPK, ka detajuar analizën e koston në trajtë analitike, duke e argumentuar me prova dhe fakte dhe ka justifikuar çmimin e ofertuar për çdo zë. Gjithashtu, operatori ekonomik “BAULED” SHPK ka argumentuar edhe elemente të tjera favorizuese në përmbushje të kushtit për zgjedhje teknike të favorshme, si lidhjet me prodhuesit, kontrata furnizimi, oferta nga furnizues të jashtëm, duke e provuar me dokumentacion justifikues. Për sa i përket origjinalitetit të mallrave, operatori ekonomik “BAULED” SHPK, ka paraqitur deklaratat e zhdoganimit të disa prodhuesve ose distributorëve të autorizuar, të cilat provojnë bashkëpunimin me palët më sipër për realizimin e kontratës. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se ankimuesi ka përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së, duke argumentuar në mënyrë bindëse të gjitha elementet e ofertës së tij dhe duke analizuar në mënyrë të detajuar secilin prej tyre.

III.1.8. Komisioni gjykon, se një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik “BAULED” SHPK, janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, origjinalitetin e punës, furnizimeve nga ofertuesi, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga operatori ekonomik “BAULED” SHPK, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Akoma më tej, Komisioni sjell në vëmendje faktin, se është detyrim i operatorëve ekonomikë, që në rast të shpalljes fitues, t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtën cilësi, të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të të detyrimeve që rrjedhin nga LPP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit/punës/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet sipas parashikimeve të *lex specialis* për prokurimin publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ITE GROUP” SHPK, nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ITE GROUP” SHPK, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “BAULED” SHPK *“Nga verifikimet e kryera në të dhënat publike për Shoqërinë BAULED SHPK rezulton se ky Operator*

Ekonomik nuk plotëson Kapacitetet financiare dhe ekonomike pasi xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit financiare është me e ulët se ajo e kërkuar nga ligji”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 2.2.1 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së pëllogaritur të kontratës.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se OE “BAULED” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Deklaratë angazhimi si subjekt mbështetës;

-Formular Përmbledhës i Vetëdklearimit nga OE FUSHA SHPK;

-Vërtetim Nr. T11648067 datë 16.10.2024 Vërtetim (Për xhiron e tre viteve të fundit të OE FUSHA SHPK;

-Pasqyrat financiare (2021,2022,2023) nga OE FUSHA SHPK;

-Formular Përmbledhës i Vetëdklearimit nga OE BAULED SHPK;

-Vërtetim Nr. T11445672 datë 19.09.2024 Vërtetim (Për xhiron e tre viteve të fundit të OE BAULED SHPK;

-Pasqyrat financiare (2021,2022,2023) nga OE BAULED SHPK;

III.2.3. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efëçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor,*

social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

Neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.2.6. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit "ITE GROUP" SHPK, KPP vëren se në rastin konkret, ofertues kemi një operator ekonomik OE BAULED SHPK, i cili ka deklaruar si subjekt mbështetës OE "FUSHA" SHPK.

Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri kualifikimi konkretisht për xhiron, ndryshe nga sa pretendon ankimuesi, OE "BAULED" SHPK ka ngarkuar në sistem (referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar në KPP me shkresën nr. 4295 prot., datë 14.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3280/3 prot., datë 18.11.2024, me objekt "Vendim" dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues (Vendimi datë 14.11.2024 KSHA), vërtetimet e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës për xhiron e tre viteve të fundit, pasqyrat financiare të 2021,2022,2023, Formular Përmbledhës së vetdeklarimit, deklaratë mbi subjektin mbështetës OE FUSHA SHPK, shoqëruar me xhiron e tre viteve të fundit, pasqyrat financiare të 2021,2022,2023, Formular Përmbledhës së vetdeklarimit. Koncretisht, në rastin kur operatori ekonomik OE BAULED SHPK, ka deklaruar subjekt mbështetës OE FSUHA SHPK për përmbushjen e kriterit 2.2.1 financiar, për xhiron e tre viteve të fundit, ka deklaruar Vërtetim Nr. T11445672 datë 19.09.2024, për xhiron e tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) por vlera e xhiros së deklaruar nga ky operator ekonomik është në masën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor për kriterin financiar të xhiros së tre viteve të fundit, referuar pikës 2 të nenit 90 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. KPP konstaton se, vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet nga autoriteti kontraktor, është 250,000,000 lekë. Mbështetur në vërtetimet e xhirove të 3 viteve të fundit për subjektin BAULED: 333,121,646 lekë > 500,000,000 (xhiro për vitin 2021); 375,353,508 lekë > 500,000,000 lekë

(xhiro për vitin 2022); 301,917,244 lekë > 500,000,000 lekë (xhiro për vitin 2023); Nga sa më sipër përlllogaritur, KPP konstaton se, asnjëra vlerë e secilit vit (2021,2022,2023) të deklaruar nga operatori ekonomik BAULED SHPK nuk përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor që ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës. Për përmbushjen e këtij kriteri, OE BAULED SHPK ka deklaruar subjekt mbështetës OE FUSHA SHPK, në përmbushje të kriterit 2.2.1 Xhiron e tre viteve të fundit. Subjekti Mbështetës FUSHA SHPK ka dorëzuar vërtetim xhiro e tre viteve të fundit me Nr. T11648067 datë 16.10.2024, 3,283,516,567 lekë > 500,000,000 (xhiro për vitin 2021), 3,268,283,488 lekë > 500,000,000 (xhiro për vitin 2022), 3,743,926,507 lekë > 500,000,000 (xhiro për vitin 2023), pasqyrat financiare të 2021, 2022, 2023, Formular Përmbledhës së vetdeklarimit.

Në këtë kuadër, referuar të dhënave të dokumentacionit të operatorit ekonomik BAULED SHPK si edhe kërkesave për kualifikim, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.2.1, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga OE “BAULED SHPK” SHPK në këtë procedurë prokurimi është në përputhje me kriteret për kualifikim, pasi e arrin vlerën e secilit vit (2021,2022,2023) të deklaruar nga operatori ekonomik subjekti mbështetës OE FUSHA SHPK, duke përmbush kërkesën e autoritetit kontraktor që vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Pra, dokumentacioni i paraqitur nga OE “BAULED SHPK” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm si dhe nuk përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se OE “BAULED SHPK” SHPK është në kushtet e përmbushjes së kriterit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ITE GROUP” SHPK, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e larte monetar, marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik me kushtet të përcaktuara”, me Nr. REF- 20508-09-18-2024 me objekt “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake, infrastrukturore, nëpërmjet formave të kontributit të përbashkët - materiale elektrike, Loti 2 (Faza III).”, me fond limit 250,000,000 Lek pa TVSH. Sipas kursit te kembimit valutor te banikes se Shqiperise vlera eshte 2,519,145.50 Euro. Financimi i këtij objekti është parashikuar në programet buxhetore për periudhën 2024-2026. Programi IVR, me kod projekti 24AE903, zhvilluar në datën 21.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ITE GROUP” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

